


INFORMACIONE  
PER PRINDER

# **Pezmatimi i veshit të mesëm**





# Pezmatimi i veshit të mesëm

## Çka është pezmatimi i veshit të mesëm?

Si vesh i mesëm merret hapësira pas timpanit. Ai e ka një lidhje të hollë me hapësirën e fytit. Në rast të pezmatimit kjo hapësirë mbushet me lëng dhe me tensionim dhe pezmatimi të timpanit shkakton dhimbje. Në raste të rralla me tensionim të lartë timpani mund të shpërthen dhe të rrjedhë qelbi nga veshi.

Me shikim brenda me një instrument special (Otoskop) mjeku mund të e shoh nga jashtë një skuqje apo ënjte

të timpanit dhe kështu të e konstaton një pezmatim të veshit të mesëm.

## Cilat janë shkaqet e një pezmatimi të veshit të mesëm?

Pezmatimi i veshit të mesëm shkaktohet nga viruset apo bakteret. Shpesh fëmija ka njëkohësisht një ftohje me rrjedhje të hundës.

## Si manifestohet një pezmatim i veshit të mesëm?

Fëmijët më të rritur ankohen për dhimbje veshi. Fëmijët më të vegjël

qajnë dhe kapen shpesh për veshi. Njëkohësisht mund të shfaqen ethe, shkuarje barku apo vjellje. Dalja e qelbit nga veshi tregon që në timpan është krijuar një vrimë. Në këtë rast dhimbjet shpesh qetësohen.

### **Si mjekoj një pezmatim i veshit të mesëm?**

Pasi që pezmatimi i veshit të mesëm në shumicën e rasteve shërohet vet, së pari bëhet një mjekim me mjete kundër dhimbjeve (me Paracetamol, Dafalgan, Panadol, ben-u-ron) apo Voltaren, Algifor, Ponstan etj.. Si shtesë mund të jepen pika të hundës kundër enjtes. Në kontrollin e dytë mjekësor duhet të vendoset, se a janë antibiotikët të nevojshëm. Ky kontroll bëhet normalisht pas 1-3 ditëve (sa më i ri fëmija aç më herët). Në rast të pëlcitjes së timpanit me shpërthim të qelbit duhet të fillohet direkt me mjekim me antibiotikë.

### **Çfarë janë rreziqet e një pezmatimi të veshit të mesëm?**

Normalisht në rast të pezmatimit të veshit të mesëm bëhet fjalë për një sëmundje me mundësi të mira të mjekimit. Një timpan i pëlcitur shërohet normalisht pa probleme. Rrallë mund të ketë komplikime serioze si inflamacione të eshtrave apo cipës së trurit. Pra është me rëndësi zbatimi konsekuent i terapisë së dhënë nga mjeku!

Pas pezmatimit të veshit të mesëm mund të mbesin lëngje për kohë të gjatë në veshin e mesëm. Për këtë arsye fëmijët e prekur dëgjojnë më dobët.

Në rast të mbetjes të këtij lëngu në veshin e mesëm, flitet për pezmatim kronik të tubës së veshit të mesëm. Nëse fëmija juaj edhe pas 6-8 javë duket ende të mos dëgjojë mirë apo të jetë nervoz, shkoni te mjeku i fëmijëve.

Vini re: Pezmatimet e vazhdueshme të veshit të mesëm normalisht nuk janë arsye për operimin e bajameve.

---

## **Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich**

Telefoni me pagesë për këshillime: 0900 266 71 1

## **Dhimbje veshi, çka të bëhet?**

Nëse fëmija juaj ankohet në dhimbje veshi, preferohet jepja e mjeteve kundër dhimbjes (shiko lartë). Vizita te mjeku është e arsyeshme porse jo me emergjencë, përveç pranë:

- dhimbjeve të pandërprera
- gjendjes së keqe të fëmijës përkundër mjeteve të dhimbjes
- vjellje e vazhdueshme
- dhimbje koke përkundër mjeteve të dhimbjes
- ënjte rreth veshit

Në raste të pasigurisë apo pyetjeve, ju mund të informoheni përmes telefonit për këshillime të spitalit të fëmijëve në Zürich 0900 266 7 11 (Fr. 3.23/min).